



BASHKIA
TIRANË

BASHKIA TIRANË

Plani i Angazhimit i Palëve të Interesit

Emri i Projektit: “SHTRATI I LUMIT LANA - ZHVILLIM URBAN”

TABELA E PËRMBAJTJES

1	HYRJA	4
2	PËSHKRIMI I SHKURTËR I PROJEKTIT	5
3	OBJEKTIVAT E PLANIT TË ANGAZHIMIT I PALËVE TË INTERESIT	5
4	KUADRI LIGJOR DHE POLITIKAT E ANGAZHIMIT TË PALËVE TË INTERESIT	6
	4.1 LEGJISLACIONI SHQIPTAR PËR ANGAZHIMIN E PALËVE TË INTERESIT.....	6
	4.2 KËRKESAT E BANKËS EUROPEANE TË INVESTIMEVE PËR ANGAZHIMIN E PALËVE TË INTERESIT	7
	4.3 MOSPËRPUHJET KRYESORE NDËRMJET KUADRIT LIGJOR SHQIPTAR DHE KËRKESAVE TË BEI	7
5	ANGAZHIMI I MËPARSHËM I PALËVE TË INTERESIT	8
6	IDENTIFIKIMI I PALËVE TË INTERESIT TË PROJEKTIT	8
7	INFORMIMI DHE PROGRAMI I ANGAZHIMIT I PALËVE TË INTERESIT.	165
8	MEKANIZMI I ANKESAVE	17
9	MONITORIMI DHE REPORTIMI	18
10	PËRGJEGJËSITË PËR ZBATIMIN E PLANIT TË ANGAZHIMIT I PALËVE TË INTERESIT	18

ANEKSI 1: FORMATI E ANKESAVE TË PUBLIKUT (SHqip dhe Anglisht) ERROR! BOOKMARK NOT DEFINED.

SHKURTIMET

M&S	Mjedisor dhe Social
SHMSS	Shëndeti Mjedisor, Siguria dhe Social
VPNM	Vlerësimi Paraprak i Ndikimit në Mjedis
BE	Bashkimi European
RSH	Republika e Shqipërisë
BEI	Banka Europiane e Investimeve
BT	Bashkia Tiranë, (Promotori i Projektit),
PAPI	Plani i Angazhimit i Palëve të Interesit
DPPP	Drejtoria e Përgjithshme e Punëve Publike
DIH	Drejtoria e Implementimit të Investimeve të Huaja,
DPSHS	Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve Sociale,
DPJAL	Drejtoria e Përgjithshme Juridike e Aseteve dhe Licensimit,
DPEM	Drejtoria e Politikave dhe Edukimit Mjedisor,
DPPT	Drejtoria e Përgjithshme e Planifikimit të Teritorit,
NJZP	Njësia e Zbatimit të Projektit,
AKM	Agjensia Kombëtare e Mjedisit,
ASHK	Agjensia Shtetërore e Kadastrës,
OJQ	Organizata Jo-Qeveritare,
PVR	Plani i Veprimit për Rivendosje,
PPVT	Plani i Përgjithshëm Vendor i Tiranës - 2030

1. HYRJJE

Bashkia Tiranë (BT) ka objektiv implementimin e *Projektit "Shtrati i Lumit Lana - Zhvillim Urban"* (Shih Figura 1 më poshtë). BT po planifikon të financojë Projektin me një kredi nga Banka Europiane e Investimeve (BEI) dhe për këtë qëllim po përgatitet të përputhë kuadrin ligjor shqiptar të kësaj fushe me kërkesat mjedisore dhe sociale të BEI-t. Projektin do të implementohet nga DIIH (NJZP) e Bashkisë Tiranë, dhe do të mbështetet nga një ekip konsulentësh të huaj.


Infrastruktura e qytetit të Tiranës ka një ndikim të madh në prosperitetin shoqëror dhe ekonomik të popullatës së tij, përkundër shëndetit, sigurisë dhe aspekteve mjedisore. Projektet e zhvillimit në infrastrukture përfshirë këtë *Projekt*, krijojnë asete që përmirësojnë mjedisin dhe stimulojnë rritjen ekonomike përmes punësimit dhe përmirësimit të produktivitetit.

Planifikimi, ndërtimi dhe fazat e ndërtimit dhe funksionimit të projekteve të tilla, mund të ndikojnë në grupet dhe palet e interesit, në shkallë të ndryshme edhe në kohë të ndryshme.

Dokumenti i paraqitur është Plani i Angazhimit të Palëve të Interesit (PAPI) i hartuar nga BT, në përputhje edhe me kërkesat e BEI-t, dhe përshkruan programin e planifikuar të konsultimit dhe angazhimit të palëve të interesit për Projektin.

PAPI gjithashtu përfshin mekanizmin e ankesave për njerëzit që preken dhe kanë probleme nga zbatimi i Projektit. PAPI do të përditësohet periodikisht pasi informacionet e rëndësishme të Projektit duhet të bëhen të disponueshme.

Figure 1: Shtrati i Lumit Lana – Zhvillim Urban



2. Përshkrim i Shkurtër i Projektit

Projekti “*Shtrati i Lumit Lana – Zhvillim Urban*” përfshin rehabilitimin hidroteknik të lumit Lana, me gjatësi rreth 1.8 km dhe zgjatimin dy bulevardeve “Gjergj Fishta” dhe “Bajram Curri”, që shkojnë paralelisht me lumin. Punimet e Projektit janë vazhdim i punimeve të mëparshme të rehabilitimit të lumit Lana me një gjatësi prej 16 km, në rrjedhën e sipërme të lumit Lana deri në Urën tek Teknologjiku, e cila është pikënisja e punimeve të Projektit të ri që shtrihet deri në vëndkalimin e rrugës “Teodor Keko”, e njohur gjithashtu si Unaza e Re.

Objektivat dhe punimet e parashikura të Projektit janë në përputhje me kërkesat e Planit të Përgjithshëm Vendor të Tiranës 2030, i miratuar nga Bashkia Tiranë.

Projekti gjithashtu përfshin pajisjen e zonës pranë lumit me infrastrukturë dhe shërbime urbane, siç janë furnizimi me ujë, kullimi, kanalizimet e ujërave të zeza, ndriçimi publik, telekomunikacioni dhe peizazhet. Në të dy anët e lumit do të ndërtohen korsi biçikletash (2.5 m të gjera), një vendkalim këmbësorësh (2 m i gjerë) dhe një pistë vrapimi (e gjerë 2 m). Projekti do të përfshijë gjithashtu punime pastrimi dhe zgjerimi në shtratin e lumit Lana, rregullimin dhe ri-drejtimin e rrjedhës së lumit për të shmangur problemet e përmytjes në këtë zonë. Mbi lumin Lana janë planifikuar të ndërtohen 2 ura automobilistike, me korsi për biçikleta dhe trotuare për këmbësorë, duke përmirësuar integrimin dhe lidhjen e të dy brigjeve të lumit me qytetin. Rëndësi e veçantë i është kushtuar kushteve të sigurie dhe lehtësive të lëvizjes së këmbësorëve dhe personave me aftësi të kufizuara, duke siguruar trotuare me hapësira të bollshme dhe minimizuar barrierat arkitekturore. Projekti do të zbatohet në një sipërfaqe me gjerësi 70 m, e cila përfshin përafërsisht 28m gjerësi të rehabilitimit të shtratit të lumit Lana dhe 21m gjerësi të bulevardeve në dy anët e lumit.

Në fazën e zbatimit të Projektit do të ketë ndikime negative mjedisore ndër të cilat përfshihen zhurma dhe pluhuri, gjenerim i mbeturinave, ndikimin vizual, ndotje e tokës, prezencë ujërave të zeza dhe ndikime në biodiversitet. Sidoqoftë, të gjitha këto pasoja do të jenë të përkohshme dhe të kthyeshme. Plani i Menaxhimit të Mjedisit në dispozicion, i hartuar si pjesë e Vlerësimit Paraprak i Ndikimit në Mjedis, propozon masa lehtësuese për adresimin e tyre. Përdorimi i makinerive specifike dhe sinjalizimi i duhur gjatë punimeve, zëvendësimi i bimësisë së dëmtuar me speciet lokale sipas rekomandimit të specialistëve të biodiversitetit, vendet për ndarjen dhe depozitimin e mbeturinave, kontrollat për shkarkimet e ujit dhe ujitje për të shmangur pluhurin, janë ndër masat zbutëse të propozuara ndaj këtyre pasojave. Të gjitha këto masa konsiderohen të pranueshme për të garantuar ndikim minimal në mjedis gjatë fazës të zbatimit të punimeve të Projektit.

Zbatimi i Projektit gjithashtu kërkon zhvendosjen e përafërsisht 1,150 personave që jetojnë në zonën e prekur nga zbatimi i Projektit edhe rreth 320 struktura ndërtimore, shumica e të cilave janë ndërtuar në mënyrë informale dhe pa leje. BT po punon për hartimin e Planit të Veprimit për Rivendosje (PVR), në përputhje me legjislacionin kombëtar dhe kërkesat e BEI, i cili do të zbatohet për të siguruar që standardi i jetesës dhe mjetet e jetesës të gjithë personave të prekur nga Projekti të jenë rivendosur plotësisht, dhe nëse është e mundur, të përmirësohen, në krahasim me situatën e para zhvendosjes. Personat e prekur do të informohen dhe këshillohen gjatë zhvillimit dhe zbatimit të PVR, sipas kërkesave të BEI-t.

3. Objektivat e Planit të Angazhimit i Palëve të Interesit

Qëllimi kryesor i PAPI është të rrisë efektivitetin e marrëdhënieve me të gjithë palët dhe aktorët e Projektit. PAPI paraqet parimet e përgjithshme, si dhe mekanizmat dhe mjetet që do të përdoren për angazhimin e palëve të interesit gjatë gjithë ciklit jetësor të Projektit.

Qëllimi i PAPI është:

- a. Të krijojë një qasje sistematike ndaj angazhimit të palëve të interesuara që do të ndihmojnë BT të identifikojë palët e interesuara dhe të ndërtojë dhe të mbajë një marrëdhënie konstruktive me ta, veçanërisht njerëzit e prekur nga zbatimi i Projektit;
- b. Për të siguruar që informacionet e duhura të Projektit mbi rreziqet dhe ndikimet mjedisore dhe sociale u janë bërë të ditur palëve të interesit në një mënyrë, format dhe kohën e duhur, të kuptueshme, të arritshme dhe të përshtatshme,
- c. Të mundësojë që pikëpamjet e palëve të interesuara të merren parasysh në hartimin e Projektit dhe performancën mjedisore dhe sociale,
- d. Të sigurojë për palët e prekura nga Projekti, mjete të arritshme dhe gjithëpërfshirëse për të ngritur çështje dhe ankesa, dhe t'i lejojë BT të përgjigjet dhe të menaxhojë ankesa të tilla.

4. Kuadri Ligjor dhe Politikat për Angazhimin e Palëve të Interesit

Projekti do të zbatohet në përputhje me ligjet dhe rregullat në fuqi në Republikën e Shqipërisë, të cilat në masë të konsiderueshme përputhen me standardet e BE-së, si dhe politikat dhe standardet e zbatueshme të BEI-t. Kërkesat e kuadrit ligjor shqiptarë për këtë çështje janë përmbledhur si më poshtë.

4.1 Kuadri Ligjor i Shqipërisë për angazhimin e palëve të interesit

Shpërndarja e informacionit dhe aktiviteteve të konsultimit sipas legjislacionit shqiptar, me rëndësi për këtë projekt, do të kryhen gjatë procesit të vlerësimit të ndikimit në mjedis, zhvillimit dhe miratimit të planit urban dhe shpronësimit. Procedura e angazhimit të palëve të interesit mbështetet në kuadrin ligjor si më poshtë vijon:

- a. Referuar kërkesave të Ligjit Nr. 10440, datë 7.7.2011 “Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis” (VNM), për këtë Projekt BT përgatiti Vlerësimin Paraprak të Ndikimit në Mjedis si dhe Draft Projekt Zbatimin, të cilët ju dërguan Agjencisë Kombëtare të Mjedisit (AKM). Në përputhje me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 247, datë 30.04.2014.¹, AKM së pari publikoi kërkesën e BT për të përcaktuar nëse VNM për Projektin është e nevojshme, së bashku me informacionin mbi Projektin. AKM-ja botoj vendimin e marrë në faqen zyrtare të Agjencisë dhe Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit. Sipas këtij vendimi AKM-ja vendosi që një VPNM e plotë nuk është e nevojshme për këtë Projekt. Sipas ligjit, vendimi i AKM përfshin gjithashtu arsyet dhe konsideratat kryesore mbi të cilat bazohet ky mendim, mendimet e institucioneve të konsultuara dhe një përshkrim të masave kryesore që duhet të merren për të shmangur, zvogëluar dhe, nëse është e mundur, të korrigjohen nëse është e mundur ndikimet negative në mjedis.
- b. Ligji Nr.107/2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Teritorit” (i amenduar me Ligjin Nr. 288/2017), rregullon konsultimet dhe organizimin e takimeve publike gjatë zhvillimit ose hartimit të planeve përkatëse urbane, siç është Plani i Përgjithshëm Vendor i Tiranës 2030, i cili është baza për këtë Projekt. Autoriteti i Planifikimit njofton publikun dhe palët e interesuara për vendndodhjen, datën dhe kohën e secilit takim publik dhe vë në dispozicion projekt dokumentin e planifikimit, të paktën 30 ditë para takimit. Njoftimi bëhet përmes publikimit të informacionit në regjistër dhe në 2(dy) gazeta kryesore/media të tjera. Komentet dhe sugjerime për PAPI-n, të marra gjatë procesit të botimit, do të konsiderohen dhe do të reflektohen në versionin final të PAPI-t.
- c. Ligji Nr.8561, datë 22.12.1999 “Për Shpronësimet dhe Marrjen në Përdorim të Përkohshëm të Pasurive Pronë Private për Interes Publik” (i amenduar me Ligjin Nr. 20/2016, datë 10.3.2016) përcakton dhe

¹ Për Përcaktimin e Rregullave, Kërkesave dhe Procedurave për Informimin dhe Përfshirjen e Publikut në Vendimmarrjen Mjedisore

rregullon procesin e angazhimit të qeverisë me njerëzit e prekur nga marja/blerja e përhershme dhe e përkohshme e tokës. Ligji përcakton ndër të tjera, me publikimin e kërkesës së shpronësimit dhe vendimin e shpronësimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Shqipërisë, si dhe në median e shkruar vendore dhe kombëtare.

Vendimi i shpronësimit gjithashtu u dërgohet individualisht personave të interesuar që kanë të drejta ligjore zyrtare, nga Ministria kompetente.

4.2 Kërkesat e BEI-t për Angazhimin e Palëve të Interesit

Krahas kërkesave të kuadrit ligjor shqiptar të përshkruara në paragrafin e mësipërm, Projekti duhet të përmbushë gjithashtu edhe kërkesat për angazhimin e palëve të interesit dhe standartet mjedisore e sociale të BEI-t, veçanërisht Standartin 10 “Për Angazhimin e Palëve të Interesit”, specifikisht në procedurat e shpërndarjes së informacionit, konsultimeve dhe trajtimin e ankesave të paraqitura.

Veprimet e nevojshme për t’u ndërmarë përmbledhen si më poshtë:

- Puna për identifikimin e palëve të interesuara, planifikimin dhe zbatimin e detyrave, e dokumentuar në përmbajtje dhe gjatë procesit;
- Publikimi dhe shpërndarja e informacionit të duhur për publikun;
- Konsultime të rëndësishme me palët e interesuara për të marrë kontributin e tyre, të iniciuara që në fillimet dhe në vazhdim gjatë gjithë ciklit jetësor të projektit, përfshirë komunitetet e prekura dhe palet e tjera, përfshirë edhe grupet në nevojë;
- Krijimi i një mekanizmi përmes të cilit njerëzit mund të paraqesin komente ose ankesa (mekanizëm i ankesave).

Kërkesa specifike për angazhim zbatohen në rastet e zhvendosjes së pavullnetshme, siç përshkruhet në Standardet e Mjedisit dhe Social, Standardi 6 të BEI-t “Për Zhvendosjen e Pavullnetshme” dhe në rastet e grupeve të cenueshme, siç përshkruhet në Standardin 7 “Të Drejtat dhe Interesat e Grupeve në Nevojë”.

Informacioni i mësipërm është vetëm një përmbledhje e kërkesave kryesore dhe i është referuar kërkesave të standarteve² në fuqi.

4.3 Dallimet kryesore midis Kuadrit Ligjor të Shqipërisë dhe kërkesave të BEI-t

Janë identifikuar disa mospërputhje midis kuadrit ligjor shqiptar në lidhje me angazhimin e palëve të interesit për Projektin dhe kërkesave të BEI-t, si më poshtë vijon:

- BEI kërkon hartimin dhe zhvillimin e Planit të Angazhimit të Palëve Interesuara, për të organizuar dhe udhëhequr punën për shpërndarjen e dokumenteve të projektit, organizimin e konsultimeve me persona ose pale të interesit etj.
- BEI kërkon një qasje shumë proactive në marrjen e opinionit publik dhe identifikimin dhe bashkëveprimin me të gjithë aktorët, përkundër një qasjeje të menjëhershme, d.m.th. duke iu përgjigjur vetëm komenteve /pyetjeve të paraqitura dhe çështjeve të ngritura, pasi ato të jenë dorëzuar;
- BEI kërkon vëmendje të veçantë në identifikimin dhe përfshirjen e grupeve në nevojë;
- Konsultimet me palët e interesuara, sipas kërkesave të BEI, duhet të vazhdojnë për gjithë kohëzgjatjen e Projektit, në krahasim me konsultimet e përqëndruara gjatë periudhës së zbatimit të punimeve;

² Standarti BEI 10, në Standardet e Mjedisit dhe Social, Versioni 10.0 i 08/10/2018:

http://www.eib.org/attachments/strategies/en_ambiental_and_social_practices_handbook_en.pdf

- BEI kërkon krijimin dhe funksionimin e një mekanizmi të ankesave të dedikuar për Projektin (i arritshëm për të gjithë palët e interesuara, përfshirë grupet në nevojë), përpos procedurave kombëtare të ankesave administrative dhe gjyqësore;

PAPI është përgatitur për të adresuar mospërputhjet e listuara më lart dhe për të siguruar që të gjitha kërkesat e BEI-t lidhur me angazhimin e palëve të interesit janë adresuar në mënyrë të duhur nga Projektin.

5. Angazhimi i mëparshëm i Palëve të Interesit

Plani i Përgjithshëm Vendor i Tiranës – 2030 (PPVT) u miratua në fillim të vitit 2017, pas një procesi të gjerë të përfshirjes së palëve të interesit dhe gjithashtu dëgjësive me pjesëmarrjen e një publiku të gjerë, me ekspert të gjithë fushave, konform kuadrit ligjor shqiptar. PPVT përmban strategjinë e zhvillimit të qytetit dhe një përshkrim të përgjithshëm të masave të propozuara, ndër të tjera për përmirësimin e trafikut (edhe në energji, ambient, etj.) në Tiranë.

Zbatimi i Projektit të propozuar kryhet në përputhje me kushtet e përcaktuara nga Plani i Përgjithshëm Vendor i Tiranës dhe me publikimin e informacioneve për Projektin, personat e prekur kanë pasur mundësinë të mësojnë rreth Projektit dhe të japin komentet dhe sugjerimet e tyre. Administrata e BT që në fazat fillestare të përgatitjes të Projektit në vitin 2018, zhvilloi një fushatë aktive konsultimi, e cila përfshiu një seri takimesh dhe dëgjësash me palët e interesit për të lehtësuar rrjedhën e informacionit midis qeverisë dhe BT, si promotor i projektit.

BT deri në këto momente gjithashtu ka publikuar Draft Projektin dhe Raportin Paraprak për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis (VNM), siç kërkohet nga legjislacioni kombëtar. Për më tepër, BT është në përfundim të hartimit të Planit të Veprimit për Rivendosje, për këtë Projekt, i cili do të zbatohet gjithashtu duke marrë parasysh kërkesat e legjislacionit shqiptar dhe rregullave të BEI-së, përfshirë ato kërkesa që lidhen posaçërisht me angazhimin e palëve të interesit dhe me personat e prekur nga blerja e tokës etj.

Raporti Paraprak i VNM është përgatitur nga një konsulentet ekspertë të punësuar nga BT në periudhën Mars-Korrik 2018. Raporti VNM është përgatitur duke ju referuar kuadrit ligjor shqiptar por edhe Direktivave të Komisionit Europian për ambientin. BT paraqiti një kërkesë me shkrim AKM për të përcaktuar nëse kërkohet një VNM e plotë. Pas prezantimit të kërkesës, VNM paraprake, në shqip dhe anglisht, u njoftua dhe u botua në faqen e internetit të BT më 3 Tetor 2018 dhe në faqen e internetit të BEI-t, më 6 Nëntor 2018, për një periudhë prej 20 ditësh.

Në fund të periudhës së publikimit të VNM-së paraprake, më 19 mars 2019, AKM-ja njoftoi me shkrim dhe publikoi Vendimin e saj (në faqen e internetit) duke argumentuar se për Projektin aktual nuk kërkohet të kryehen procedura për përgatitje të VNM të plotë.

DPSHS në koordinim me DIIH ka punuar për hartimin e Planit të Veprimit për Rivendosje (PVR). DPSHS në periudhën 1 maji 2018 deri më 11 Gusht 2018, ka kryer regjistrimin (census) dhe anketimin për të dhënat socio-ekonomike të popullsisë që preken nga zhvendosjet fizike dhe/ose ekonomike për efekt të zbatimit të Projektit.

Përpjekje të mëtejshme do të bëhen edhe gjatë procesit të kompensimit/shpronësimit, zhvillimit dhe zbatimit të PVR.

6. Identifikimi i Palëve të Interesit për Projektin

Palë e Interesi përcaktohet çdo individ ose grup potencialisht i interesuar për një Projekt ose që ka interes për zbatimin e Projektit.

Qëllimi i identifikimit të palëve të interesit është përcaktimi i organizatave dhe njerëzve që mund të ndikohen drejtpërdrejt ose indirekt (të dyja pozitivisht edhe negativisht) nga Projektin, si dhe palët që mund të interesohen dhe / ose të kenë një ndikim pozitiv ose negativ në Projekt.

Në kontekstin e procesit të identifikimit të palëve të interesuara të Projektit për zhvillimin e këtij PAPI, janë marrë në konsideratë aspektet e mëposhtme:

- Ndikime të mundshme të Projektit gjatë ndërtimit dhe operacioneve;

- Mënyra e përfshirjes së palëve të interesit të kërkuar nga legjislacioni shqiptar dhe standardet e BEI-t;
- Kush ka mundesine të preket drejtpërdrejt ose indirekt nga ndikimet e mundshme në fushën e influencës të zbatimit të Projektit.
- Kush janë grupet në nevojë që kërkojnë përpjekje speciale për përfshirje;
- Kush mbështet ose kundërshton ndryshimet që do të sjellin aktivitetet e Projektit dhe pse.

Tabela 1 më poshtë jep një përmbledhje të palëve të interesit të identifikuara nga BT deri më sot, si dhe llojin dhe mënyrën e komunikimit që do të përdoret me secilin prej tyre dhe do të jetë përgjegjësi e BT, në bashkëpunim me Kontraktorët. Tabela 1 do të amendohet në mënyrë periodike, gjatë ciklit të Projektit, për të përfshirë të gjithë aktorët e identifikuar së fundmi, si dhe aktivitetet e planifikuara të angazhimit dhe afatet kohore.

Tabela 1: Identifikimi i palëve të interesit të projektit dhe metodat e komunikimit për programin e ardhshëm të angazhimit të palëve të interesit.

Tabela 1: Identifikimi i palëve të interesit të Projektit dhe metodat e komunikimit për programin e ardhshëm të angazhimit të palëve të interesit.

Palët e Interesit	Lloji dhe mënyra e komunikimit	Afati	Përgjegjësia për Zbatimin	Temat kryesore me interes për diskutim
Banorët dhe kompanitë që operojnë përgjatë gjurmës së Projektit (të cilët nuk do të zhvendosen, por do të vazhdojnë të banojnë/ operojnë përgjatë bulevardëve të reja).	Takime për këshillim publik për të shpallur Projektin dhe për të prezantuar ndikimet dhe masat lehtësuese sociale dhe ambientale, si edhe për të marrë opinionet, sipas këndvështrimit të publikut.	Janar 2020	NJZP DPEM, DPPT	<p><u>Faza e para ndërtimit:</u></p> <ul style="list-style-type: none"> - Përshkrimi i projektit; ndikimet e pritura pozitive dhe negative të pritura, si dhe masat e planifikuara të zbatjes. - Mundësitë për punësim direkt dhe indirekt gjatë zbatimit të Projektit - Aktivitetet e planifikuara për angazhimin e palëve të interesit - Afatet e zbatimit të Projektit - Mekanizmi i ankesave të projektit <p><u>Faza gjatë ndërtimit:</u></p> <ul style="list-style-type: none"> - Detajet e kontaktit të kontraktorit (ëve); - Menaxhimi i trafikut - Njoftime për çdo veprimtari që mund të rezultojë në ndërprerje afatshkurtra të shërbimeve; - Informacion mbi ecurinë e ndërtimit dhe problemet.
	Informacion mbi Projektin, VNM-në paraprake dhe PAPI-n të publikuara në faqen e internetit të BT: http://www.tirana.gov.al	Janar 2020	NJZP	
	Information nëpërmjet medias së shkruar: gazetat “Panorama” “Gazeta Shqiptare”, dhe gjithashtu asaj elektronike.	Në vazhdim gjatë zbatimit të Projektit	NJZP	
	Komunikim nëpërmjet buletineve të bordeve (te vendosur afar kantierit të punimeve); tabela për ndërtimin dhe paralajmërimet	Përpara fillimit të zbatimit të punimeve.	Kontraktori/ët	
	Mekanizimi i Ankesave	Janar 2020 dhe në vazhdim gjatë zbatimit të Projektit	Sipas Kapitullit 8.	

Palët e Interesit	Lloji dhe mënyra e komunikimit	Afati	Përgjegjësia për Zbatimin	Temat kryesore me interes për diskutim
Koordinatorët lokale dhe Këshillat e Njësive Administrative 6 dhe 7, Tiranë.	Korrespondencë zyrtare dhe takime. Informationi do të jepet direkt nga BT (NJZP)	Tashmë në proces dhe për të vazhduar për gjithçka Faza e zbatimit të punimeve të Projektit dhe faza e operimit (nëse duhet)	NJZP DPPT	<ul style="list-style-type: none"> - Ankesat nga personat e prekur dhe pjesëmarrja në trajtimin e tyre - Organizimi dhe pjesëmarrja në aktivitetet e shpërndarjes dhe konsultimit - Progresi i projektit - Raportet e monitorimit të projektit, përfshirë ankesat.
<p>Popullsia që do të preket nga blerja e tokës (pronarët dhe përdoruesit e tokës dhe operatorët e bizneseve brenda gjurmës së Projektit, të cilët do të zhvendosen fizikisht dhe / ose ekonomikisht).</p> <p>Grupe më nevojë midis personave të prekur (të identifikohen gjatë zhvillimit të RAP, së bashku me llojin dhe metodën e komunikimit, kohën dhe temat për diskutim)</p>	<p>Draft RAP i publikuar në faqen e internetit të BT: http://www.tirana.gov.al; Takime konsultimi për të prezantuar draftin e RAP dhe për të marrë komente.</p> <p>Takime individuale dhe njoftime me shkrim në lidhje me marrjen dhe shpronësimin e tokës.</p> <p>Mekanizimi i Ankesave</p>	<p>Shkurt 2020</p> <p>Në zhvillim gjatë marrjes /kompensimit të truallit.</p> <p>Shkurt 2020 dhe në vazhdim gjatë zbatimit të Projektit</p>	<p>DPSHS DPJAL</p> <p>DPSHS DPJAL</p> <p>Sipas Kapitullit 8.</p>	<ul style="list-style-type: none"> - Prezantim i detajuar i gjurmës të Projektit, truallit dhe pasurisë. - Legjislacioni Kombëtar në fuqi. - Matrica e të drejtave sipas RAP - Lloji dhe mënyra e kompensimit dhe rivendosjes/ndihmës për rivendosjen e aseteve. - Mekanizmi i ankesave
Agjensia Shtetërore e Kadastrës	Korrespondencë zyrtare dhe takime	<p>Maj 2019 dhe në vazhdim gjatë marrjes/kompensimit së truallit.</p> <p>Shkurt 2020, data e fillimit të kompensimit / shpronësimit të truallit</p>	NJZP DPJAL	<ul style="list-style-type: none"> - Siguron BT me të dhënat mbi pronësinë e tokës të regjistruar zyrtarisht në zonën e përfshirë në projekt. - Infromon BT për çmimin e truallit dhe strukturave, sipas zonës (të jepet si kompensim në kontekstin e procesit të shpronësimit).

Palët e Interesit	Lloji dhe mënyra e komunikimit	Afati	Përgjegjësia për Zbatimin	Temat kryesore me interes për diskutim
OJQ të interesuara, shoqatat e qytetarëve dhe organizata ³ të tjera.	Takime konsultimi me publikun për të informuar mbi Projektin dhe për të prezantuar ndikimet e pritura në planin Social dhe Ambiental, masat lehtësuese dhe marrja e mendimeve. Takime Individuale	Janar 2020 Nëse është e nevojshme gjatë zbatimit të Projektit	NJZP DPSHS	<u>Faza përpara ndërtimit:</u> - Përshkrimi i projektit; ndikimet e pritura pozitive dhe negative si dhe masat e planifikuara për zbutjen e tyre. - Aktivitetet e planifikuara për angazhimin e palëve të interesuara - Afatet e zbatimit të projektit - Mekanizmi i ankesave të Projektit <u>Gjatë ndërtimit:</u> - Informacion mbi ecurinë e punimeve të ndërtimit dhe problemet
Publiku i qytetit të Tiranës	Informacion mbi projektin, VNM-në paraprake dhe PAPI të publikuara në faqen e internetit të BT: http://www.tirana.gov.al Information nëpërmjet medias së shkruar: gazetat “Panorama” “Gazeta Shqiptare”, dhe asaj elektronike.	Janar 2020 Në vazhdim gjatë zbatimit të Projektit	NJZP NJZP	- Përshkrimi i Projektit dhe përfitimet e pritura - Afatet e zbatimit të projektit - Progresi i zbatimit të projektit Menaxhimi i trafikut, duke përfshirë ndryshimet në transportin publik.
Bashkia e Tiranës, përfshirë kryetarin e bashkisë dhe përfaqësues të Departamenteve të ndryshme përgjegjëse për: Mbrojtjen sociale, Strehimin social, kompensimin/shpronësimin,	Korrespondencë zyrtare dhe takime Raportimi i rregullt brenda BT (raportet e progresit dhe monitorimit) për të përgatitur dhe koordinuar aktivitetet para dhe gjatë ndërtimit	Në proces Të zgjasë gjatë gjithë fazës së zbatimit të Projektit dhe fazës së funksionimit (nëse duhet)	NJZP DPSHS DPPT	Koordinimi i aktiviteteve përpara dhe gjatë fazës së ndërtimit të Projektit, duke iu përgjigjur ankesave dhe adresuar çështjet shqetësuese për komunitetet lokale, të paraqitura. <u>Faza e para ndërtimit:</u>

³ Aktualisht nuk ka OJQ ose organizata të tjera të interesuara posaçërisht për Projektin, megjithatë nëse do të tregojnë interes për Projektin në një fazë të mëvonshme, ato do të shtohen në listën e palëve të interesit.

Palët e Interesit	Lloji dhe mënyra e komunikimit	Afati	Përgjegjësia për Zbatimin	Temat kryesore me interes për diskutim
Punët publike, Financat, Pronën dhe Çështjet ligjore, Mbrojtja e mjedisit, Menaxhimi i trafikut, Zyra e marrëdhënieve me publikun, NJZP dhe Njësia e Rivendosjes.	dhe ofrimi i informacionit të rregullt mbi mbarëvajtjen e Projektit dhe adresimi i çështjeve shqetësuese për komunitetet lokale, kur ato paraqiten.			<ul style="list-style-type: none"> - Kërkesë për marrjen e lejes së ndërtimit për Projektin - Përshkrimi i projektit dhe afatet kohore; detyrimet për zbatimin e masave lehtësuese mjedisore dhe sociale. - Detyrimet e BT nga PAPI dhe PVR - Informacion mbi progresin e punimeve të ndërtimit dhe problemet.
<p>Drejtuesit dhe operatorët lokalë të shërbimeve komunale:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Ujësullës Kanalizime dhe Sisteme të Ujërave të Zeza Tiranë - Operatori i Shpërndarjes së Energjisë, Tiranë - Bordi i Baseneve Ujore të Tiranës 	<p>Korrespondencë zyrtare dhe takime për të përgatitur dhe koordinuar aktivitetet gjatë ndërtimit</p> <p>Reportet e Progresit të punimeve</p>	Përpara dhe gjatë zbatimit të punimeve	NJZP Kontraktori(ët)	<ul style="list-style-type: none"> - Zhvillimi i dokumenteve të projektit dhe planeve për shërbimet publike - Progres në autorizime dhe ndërtim - Transferimi i pronësisë mbi objektet pas ndërtimit - Përgjegjësia për mirëmbajtjen gjatë shfrytëzimit
Ministria e Infrastruktues dhe Energjisë	Korrespondenca zyrtare dhe takime	Përpara dhe gjatë zbatimit të Projektit	NJZP	<ul style="list-style-type: none"> - Politikat e sigurisë rrugore dhe detyrimet për BT - Shëndeti dhe siguria në punë - Planifikimi, përgatitja dhe aprovimi i dokumentacionit të projektit dhe zbatimi i projektit
Ministritë e tjera, sipas nevojës, veçanërisht Ministria e Turizmit dhe Mjedisit dhe Agjencia Kombëtare e Mjedisit	Korrespondenca zyrtare dhe takime	Gjatë zbatimit të punimeve	NJZP Drejtoritë përkatëse të BT	<ul style="list-style-type: none"> - Monitorimi i mjedisit

Palët e Interesit	Lloji dhe mënyra e komunikimit	Afati	Përgjegjësia për Zbatimin	Temat kryesore me interes për diskutim
Media E shkruar: Panorama, Gazeta Shqiptare, Radio Tirana, Top Albania Radio, TV: RTSH, News 24.	Website: www.tirana.gov.al	Përpara dhe gjatë zbatimit të Projektit	NJZP	<ul style="list-style-type: none"> - Përshkrimi i Projektit dhe përfitimet - Afatet e zbatimit të Projektit - Shpallja e ngjarjeve të ardhshme të zbulimit dhe konsultimit - Përditësimet e ecurisë së projektit - Planet e menaxhimit të trafikut - Njoftime për çdo veprimtari që mund të rezultojë në ndërprerje afatshkurtra të punimeve
Bank Europiane e Investimeve Ba	Korrespondencë zyrtare dhe takime të rregullta	Përpara dhe gjatë zbatimit të Projektit	NJZP	<ul style="list-style-type: none"> - Ndihmë teknike për BT - Dorëzimi i draftit dhe raportit përfundimtar të PVP - Dorëzimi i raporteve dyvjeçare të Mjedisit, Shëndetit, Sigurisë dhe atyre Socialeve, përfshirë menaxhimin e ankesave - Dorëzimi i draft raportit të PVR dhe raportit përfundimit të PVR
Punonjësit e BT	Takime individuale Takimet e punonjesve të brendshëm Gazetat mujore Informacion nga punonjësit dhe inspektorët në terren	Gjatë zbatimit të Projektit	BT	<ul style="list-style-type: none"> - Politika e burimeve njerëzore - Mekanizmi i brendshëm i ankesave - Procedurat e shëndetit dhe sigurisë - Kodi i Sjelljes - Masat lehtësuese mjedisore dhe sociale - Mekanizmi i ankesave të PAPI

Palët e Interesit	Lloji dhe mënyra e komunikimit	Afati	Përgjegjësia për Zbatimin	Temat kryesore me interes për diskutim
Kontraktorët (firmat e ndërtimit, nënkontraktorët dhe furnizuesit)	<p>Informacion në kontratë për standardet dhe pritshmërinë, kodi i sjelljes.</p> <p>Korrespondencë zyrtare dhe takime. Monitorim i rregullt i performancës së kontraktuesit(ëve) për zbatimin e masave M&S, për zbutjen e projektit përfshirë menaxhimin e ankesave.</p>	<p>Gjatë prokurimit dhe nënshkrimit të kontratës</p> <p>Gjatë zbatimit të Projektit</p>	NJZP	<ul style="list-style-type: none"> - Shëndeti dhe siguria në punë - Siguria - Qasja në kantier - Ndërveprimi me komunitetin - Ankesat - Ankesa mjedisore

7. Publikimi i informacionit dhe Programi i Angazhimit i Palëve të Interesit

BT synon të sigurojë të gjithë informacionin përkatës të Projektit për publikun. Të gjithë palët e interesuara dhe të prekura do të jenë në gjendje të gjejnë dokumentet e mëposhtëm në faqen e internetit të BT (www.tirana.gov.al), në shqip dhe anglisht, në periudhën e ardhshme:

- Përshkrimi jo-teknik i Projektit, (është një dokument përmbledhës që ofron një përshkrim të procesit të VNM-së dhe gjetjet e tij në një mënyrë që është tërheqës për tu lexuar dhe kuptuar lehtë nga publiku i gjerë),
- Vlerësimi Paraprak i Ndikimit në Mjedis,
- Plani i Angazhimit i Palëve të Interesit (PAPI) duke përfshirë mekanizmin e ankesave,
- Plani i Veprimit për Rivendosjen.

BT planifikon t'i kushtojë një faqe të veçantë Projektit, në faqen e saj të internetit, ku të gjithë dokumentet e projektit do të jenë në dispozicion të palëve të interesuara. Pasi të krijohet adresa e kësaj faqe në internet, do të publikohet edhe PAPI.

Për më tepër, kopje e dokumenteve të projektit do të jenë të disponueshme në adresën me poshtë:

Bashkia e Tiranës, Drejtoria e Implementimit të Investimeve të Huaja (NJZP)

Adresa: Sheshi Skënderbej, Pallati i Kulturës, kati i parë, Tiranë, Shqipëri

<http://www.tirana.gov.al> Telefon: +355 4 2266340

E-mail: henrik.hysenbegasi@tirana.al

Dokumentet do të qëndrojnë në faqen e internetit publik të BT, gjatë gjithë periudhës së kohëzgjatjes të Projektit.

Njoftimet për disponueshmërinë e dokumenteve të Projektit dhe takimeve publike të planifikuara do të botohen në gazetën “Panorama” dhe “Gazeta Shqiptare” dhe në media të tjera elektronike, jo më pak se një javë përpara datës së zhvillimit të takimeve.

Njoftimet do të bëhen në mediat e sipërpërmendura për të informuar publikun për kohën, datën dhe vendndodhjen e takimeve të këshillimit me publikun.

Në muajin Janar 2020 do të mbahen të paktën dy takime këshillimi me qëllim kryesor informimin e personave të interesuar për Projektin, afatin e pritshëm të realizimit, ndikimet dhe masat zbutëse dhe veçanërisht procedurën e menaxhimit të ankesave.

Panelet e informacionit do të instalohen në hyrje të kantierit të ndërtimit nga Kontraktori (ët). Detajet e kontaktit për paraqitjen e ankesave gjithashtu do të afishohen. Kontraktori do të sigurojë kantierin përpara fillimit të zbatimit të punimeve dhe do të sigurojë vendosjen e tabelave përkatëse ndërtimore dhe paralajmëruese në kantier.

Në muajin Shkurt 2020 do të fillojnë takimet e këshillimit për zhvillimin e PVR me pronarët dhe përdoruesit e tokës dhe pasurive të prekura nga Projekti. Ftesat për takime do të dërgohen individualisht për secilën familje/biznes të prekur nga Projekti, të paktën dy javë më përpara.

Pas përfundimit të PVR, në vijim do të mbahen takime individuale për të diskutuar kompensimin dhe ndihmën për secilën familje / biznes të prekur, si pjesë e procesit të shpronësimit kërkuar nga legjislacioni shqiptar dhe siç kërkohet nga BEI referuar PVR.

BT dhe Kontraktori (ët) gjatë zbatimit të Projektit do të vazhdojnë të angazhohen me palët e interesuara, dhe PAPI do të përditësohet vazhdimisht për të pasqyruar progresin e Projektit. Vëmendje e veçantë do t'i kushtohet komunikimit me çdo grup në nevojë të identifikuar (përmes takimeve të grupeve të fokusit që mbeten të përqendruara në temat kryesore, broshurave të Projektit ose në mënyra të tjera të përshtatshme), për të siguruar që ndikimet e Projektit mbi ata kanë patur efektin zbutës ashtu siç duhet.

8. Mekanizmi i Ankesave

BT e përfaqësuar nga NJZP ka detyrimin t'u përgjigjet të gjitha ankesave sipas procedurave të përcaktuara në legjislacionin kombëtar dhe në përputhje me standardet e BEI-t.

BT (NJZP) dhe Kontraktuesi (ët) e saj do të marrin të gjitha komentet dhe ankesat që lidhen me Projektin, të paraqitura me gojë ose me shkrim. Individët që paraqesin komentet ose ankesat e tyre kanë të drejtë të kërkojnë që emri i tyre të mbetet konfidencial. Ankesat gjithashtu mund të dorëzohen në mënyrë anonime, por kjo mund të kufizojë mundësitë për hetimin e ankesave dhe dhënien e një përgjigje.

NJZP është përgjegjëse për shqyrtimin e të gjitha komenteve dhe ankesave në lidhje me pranueshmërinë e tyre brenda 3 ditëve dhe t'i dërgojë ato pranë Drejtorive kompetente të BT, për t'u përgjigjur /vepruar /zgjidhur ankesat. Të gjitha ankesat e bëra nga Palët e Interesit në lidhje me këtë Projekt, duhet të dorëzohen përmes postës, postës elektronike ose telefonit duke përdorur informacionin e kontaktit të dhënë më poshtë:

Bashkia e Tiranës, Drejtoria e Implementimit të Investimeve të Huaja (DIIH)

Z. Henrik Hysenbegasi, Drejtor

Adresa: Sheshi Skënderbej, Pallati i Kulturës, Kati i parë, Tiranë, Shqipëri

<http://www.tirana.gov.al>

Telefon: +355 4 2266340

E-mail: henrik.hysenbegasi@tirana.al

Drejtoritë kompetente dhe personat përgjegjës për t'u përgjigjur / vepruar mbi / zgjidhur ankesat janë si me poshtë:

Z. Diana Mile, Drejtor

Drejtoria e Përgjithshme e Politikave dhe Edukimit Mjedisor,

Z. Fation Salacia, Drejtor

Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve Sociale,

Z. Alban Dokushi, Drejtor

Drejtoria e Përgjithshme Ligjore e Aseteve dhe Licencimit,

Z. Diçjon Baboçi, Drejtor i Përgjithshëm

Drejtoria e Përgjithshme e Planifikimit të Territorit

Detajet e kontaktit të Kontraktuesit (ëve) të zbatimit të punimeve gjithashtu do të bëhen të disponueshëm publikisht në zonën lokale përkatese dhe do të përfshihen në një PAPI-in e rishikuar, menjëherë pasi ai (ata) të jenë caktuar.

Një Formular i Ankesave Publike për Projektin është dhënë në Shtojcën 1 të Raportit. Formulari i Ankesave (në shqip dhe anglisht) do të vihet në dispozicion në faqen e internetit të BT, www.tirana.gov.al dhe formularët do të jenë të disponueshme për publikun.

Do të krijohet një Mekanizëm i Ankesave të Punëtorëve për punonjësit e ndërmarrjeve të ndërtimit (si një sistem i PAPI-t). NJZP do të sigurojë që Drejtorite kompetente të BT t'i përgjigjen ankesave brenda 15 ditëve nga data e pranimit të tyre. Në çdo kohë, ankuesit kanë mundësinë të kërkojnë mjete juridike në përputhje me ligjet dhe rregulloret e Republikës së Shqipërisë.

9. Monitorimi dhe Raportimi

PAPI është një dokument që ndrysho dhe duhet të rishikohet dhe përditësohet në mënyrë periodike, në përputhje me aktivitetet e reja, çdo ndryshim të Projektit dhe identifikimin e Palëve të reja të Interesit.

BT (NJZP) është përgjegjës për zbatimin e PAPI dhe do të mbajë kontakte me Drejtoritë përkatëse të BT si; Drejtoria e Përgjithshme e Politikave dhe Edukimit Mjedisor, Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve Sociale, Drejtoria e Përgjithshme Ligjore e Asrteve dhe Licencimit dhe Drejtoria e Përgjithshme e Planifikimit të Territorit (personat përgjegjës të listuar në Kapitullin 8), së bashku me Kontraktorin(ët) e punimeve të ndërtimit dhe Komunitetet Lokale, për të monitoruar dhe raportuar përsa i përket shpërndarjes së informacionit mbi konsultimet, marrjen/shpronësimin e truallit, dhe pastrimin, menaxhimin e ankesave, masat për zbutjen sociale dhe mjedisore, problemet shëndetësore dhe të sigurisë.

BT do të publikojë detaje të çështjeve të ngritura gjatë procesit të konsultimit dhe do të sigurojë informacionin e ardhur si në faqen e saj të internetit, ashtu dhe me shkrim në zyrat NJZP në Tiranë.

Gjatë gjithë projektit, NJZP do të komunikojë me palët e interesuara dhe do t'i informojë ata për çdo çështje të rëndësishme, për shembull, ndryshimet në afatet e programit të realizimit të Projektit. BT (NJZP) do të sigurojë përditësimin e Projektit në faqen e saj të internetit dhe gjithashtu do të sigurojë broshura për komunitetet lokale, sipas kërkesave.

PAPI do të përditesohet në mënyrë periodike (të paktën një herë në 4 muaj) si vijon:

- Regjistroni konsultimet e ndërmarra, çështjet e ngritura, veprimet e ndërmarra;
- Përshkruani mësimet e marra dhe çdo ndryshim në procesin e zbulimit dhe konsultimit; dhe,
- Të përshkruajë orarin për ndërveprimin e vazhdueshëm dhe të ardhshëm me palët e interesuara.

10. Përgjegjësia për Implementimin e PAPI

BT, e përfaqësuar nga NJZP, ka përgjegjësinë e përgjithshme për zbatimin e Planit të Angazhimit të Palëve të Interesit(PAPI) dhe për pranimin dhe përpunimin e ankesave në lidhje me Projektin.

Për të përmbushur detyrimet e saj, NJZP do të koordinojë punën me drejtoritë e BT të cilët do të jenë përgjegjës për aktivitete të ndryshme që trajton PAPI, sipas specifikimeve të kapitujve të tij.

Detajet e kontaktit të NJZP:

Bashkia e Tiranës, Drejtoria e Implementimit të Investimeve të Huaja (NJZP)

Z. Henrik Hysenbegasi, Drejtor

Adresa: Sheshi Skënderbej, Pallati i Kulturës, Kati i parë, Tiranë, Shqipëri

<http://www.tirana.gov.al>

Telephone: +355 4 2266340

E-mail: henrik.hysenbegasi@tirana.al

Drejtoritë kompetente të BT përfshijnë:

- Drejtoria e Politikave dhe Edukimit Mjedisor,
- Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve Sociale,
- Drejtoria e Përgjithshme e Ligjit, Aseteve dhe Licencimit,
- Drejtoria e Përgjithshme e Planifikimit të Territorit
- Drejtoria e Përgjithshme e Punëve Publike

Detajet e kontaktit të Kontraktuesit të ndërtimit gjithashtu do të vihen në dispozicion të publikut në zonën lokale dhe do të përfshihen në PAPI-n e rishikuar, pasi të emërohet Kontraktori.

Annex 1: Formati i Ankesës së Publikut

FORMA E ANKESËS SË PUBLIKUT - <i>PROJEKTI SHTRATI I LUMIT LANA - ZHVILLIM URBAN</i>	
Nr. i Referencës:	
Emër, Mbiemër:	
Information për kontaktin: Ju lutemi shënoni si dëshironi të kontaktoheni (poste, telefoni, poste elektronike)	<input type="checkbox"/> Me Postë: Jep adresën e vendbanimit: _____ _____ <input type="checkbox"/> Me Telefon: _____ <input type="checkbox"/> Me E-mail _____
Gjuha për Komunikim	<input checked="" type="checkbox"/> Shqip <input checked="" type="checkbox"/> Anglisht
Pershkrimi i problemit ose Ankesës	
Cfare ndodhi? Ku ndodhi? Me kë ndodhi? Cili është rezultati i zgjidhjes së problemit?	
Data of problemit / Ankesës	
	<input type="checkbox"/> Incident / ankesë që ndodh vetëm një herë (data _____) <input type="checkbox"/> Ndodhi më shumë se një herë (sa herë? _____) <input type="checkbox"/> Vazhdimi (aktualisht duke përjetuar problem)
Cfarë do të dëshironit të shihni të ndodhte për të zgjidhur problemin?	
Firma: _____ Data: _____	
Ju lutemi dërgoni këtë formë në adresën: Bashkia e Tiranës, NJZP, Henrik Hysenbegasi, Drejtor Adresa: Sheshi Skënderbej, Pallati i Kulturës, Dhoma 4, Kati i parë, Tiranë, Shqipëri http://www.tirana.gov.al Telefon: +355 4 22366340	

PUBLIC GRIEVANCE FORM - Lana River Bank- Urban Development Project	
Reference No:	
Name and Surname:	
Contact Information: Please mark how you would like to be contacted (mail, phone, e-mail)	<input type="checkbox"/> By Post: Please provide mailing address: _____ _____ <input type="checkbox"/> By Phone: _____ <input type="checkbox"/> By E-mail _____
Preferred language for communication	x [Albanian] x [Other: English]
Description of Incident or Grievance: What happened? Where did it happen? Who did it happen to? What is the result of the problem?	
Date of Incident / Grievance	
	<input type="checkbox"/> One time incident/grievance (date _____) <input type="checkbox"/> Happened more than once (how many times? _____) <input type="checkbox"/> On-going (currently experiencing problem)
What would you like to see happen to resolve the problem?	
Signature: _____ Date: _____	
Please return this form to: Municipality of Tirana, NJZP, Henrik Hysenbegasi, Director Address: Skanderbeg Square, Culture Palace, first floor, Tirana, Albania http://www.tirana.gov.al Telephone: +355 4 22366340 E-mail: henrik.hysenbegasi@tirana.al	